

Emri i Lëndës : Identitetet dhe Komunikimi Masiv							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 403	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Suela Musta, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		Kursi i leksioneve "Identitet përmes Mediave" do të përshkruajë, paraqesë dhe studiojë strategjinë, arsyet dhe motivimin që ushqejnë diskursin mediatike të çdo forme mbi çështje të ndryshme, të vjetra e të reja të identiteteve nacionale, politike, ideologjike, kulturore, etnike, regjionale e religjioze të mbishtresuara në peisazhin e shoqërive të sotme moderne, ndër to edhe të shoqërisë shqiptare. Burimet dhe origjina e identiteteve, agjentët socio-kulturorë që e ushqejnë në dinamikën e mediave, forumet, botimeve speciale e press-konferencave të posaçme do të studiohen si në aspektet retrospektive, ashtu dhe në aspektin futurologjik. Shembujt e tolerancës dhe intolerancës, hegjemonia herë e njërit identitet e herë të një tjetri, të të shikohen nga aspekti teorik e praktik, paralel me përpjekjet për gjetjen e formulave të bashkëjetesës tolerante në një shoqëri demokratike. Rëndësi të madhe ka koncepti i qëndrueshëm i qasjes ndaj dukurive identitare, identitetit të shprehur, identitetit të rreme apo të sajuar e të ngritura në mit dhe në fundmi, konjunkturën e jashtme e të brendshme të përplasjes së identiteteve. Karakteri i leksioneve parashikon krahas nocioneve teorike edhe një diskurs të pasur e të ilustruar me shembuj nga praktika reale kombëtare e ndërkombëtare.					
Objektivat		1- Njohja e studentëve dhe aftësimi mbi nocionet e identiteteve, tipologjisë së tyre dhe shpalosja në një botë globale 2--Të kuptohet sa më qartë çështjet dhe sfidat e komunikimit të identitetit në hapësirat online, blogjet, platformat e rrjeteve sociale 3--Marrja e njohurive mbi marrëdhëniet e veta me të tjerët, në termit e psikologjisë, sociologjisë, filozofisë historisë dhe shkencave të komunikimit 4-- Njohja me cilësitë e identitetit kombëtar dhe përballjen e tyre në një botë globale 5--Aftësimi me përballjen e kulturave dhe mendësive të ndryshme të shoqërive dhe komuniteteve si brenda vendit ashtu edhe në rajon, Europë e më gjerë 6-- Njohja dhe mësimi i cilësive dhe tipareve të identiteteve të shoqërive europiane, duke iu referuar historisë, mjeteve të komunikimit -medias, dhe kulturës e artit në tërësi					
Konceptet Kryesore		Identitet, Nacionalitet, komunikim identitetet online Antropologjia Tipare historiko gjeografike, Oksidentalizmi, Orientalizmi, Globalizimi, Albanologjia Filozofi, Psikologji, Sociologji. Surrealizëm, Ekzistencializëm,dilemat, kontradiktat, koncepti i maskave, identiteti gjinor, TIK-mediumet rrjete sociale,					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Identitetet nacionale dhe formimi i tyre në prag të shoqërive moderne. Eposet kombëtare, si embrione të formimit identitar nacional.						
2	Kombi, shteti dhe Feja. Identitetet kombëtare dhe identitetet religjioze dhe projektimi mediatik.						
3	Mekanizmi i prodhimit të identitetve; roli i Medias dhe literaturës: krijimi i identiteteve kombëtare.						
4	Identiteti Ballkanik dhe identiteti kombëtar shqiptar: Roli i literaturës dhe reprezentimi mediatik i tyre në media.						
5	Identiteti shqiptar midis Lindjes dhe Perëndimit në polemikat e diskursive mediatike.						
6	Diskursi eurocentrist dhe orientalist në media.						

7	Përplasja e madhe e identiteve në median e shek 21: koncepti i bashkëjetesës humane midis traditës dhe modernitetit sipas F. Gylen.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Faktori nacional dhe identiteti në erën globaliste: Globalizëm dhe Glokalizëm
10	Orientalizmi i Eduard Said dhe refuzimi oriental i Orientalizmi në mediat shqiptare.
11	Mediat dhe islami: ideologjizimi dhe instrumentalizimi i diskursit. Mllëfi i Oriana Fallaçit.
12	Europeanizimi midis shumësisë dhe identitetit kulturor: përbërësit e identiteteve
13	Struktura trenare religjioze e shqiptarëve dhe dyfishësia mediatike ndaj happy end-it të bashkëjetesës
14	Kombi në inkubator: Mbi nocionin kombi kosovar
15	Identitetet ndërindividuale dhe identitetet gjinore
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Hyrje në ndërkommunikimin kulturor - Martin&Nakayama, UET Press, Tiranë 2010. • Leksione të përgatitura nga lektori i lëndës • Komunikimi - Christian Baylon & Xavier Mignot, Logos-A, Shkup 2004 • Oksidentalizmi - Ian Buruma & Avishai Margalit, IDK, Tiranë 2004
Referenca të tjera	• Integrimi i fesë dhe identitetit të muslimanët e Ballkanit. Dr. Musa Musai. Alsar, Istanbul 2007 • Mosmarrëveshja. Ismail Kadare. Onufri, Tiranë 2010. • Kombet dhe nacionalizmi në erën globale. Anthony D. Smith, Dudaj, Tiranë 2008. • Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në perandorinë osmane. Nuray Bozborra. Dituria. Tiranë 2002 • Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit. Eqrem Çabej, Tiranë MÇM 1996 • Çoroditja e botës. Amin Malouf, Tiranë IDK, 2009 • Identitete vrastare. Amin Malouf, Onufri, Tiranë 2006 • Krijimi i identiteteve kombëtare (Europa e shekujve XVIII-XX), Anne-Marie Thiesse, Botimet • Kanuni i Dibrës, Xhafer Martini • Kanuni i Skënderbeut, At' Frano Ilia • Kanuni i Lekë Dukagjinit, At' Shtjefën Gjeçovi • Orientalizëm apo Oksidentalizëm, Krist Maloki, Plejad • Esad Pasha tradhëtar apo patriot, Tahir Kolgjini, Kumti, Tiranë 2003 • Orientalizmi - Edward W. Said, Elbasan 2009 • Europa juglindore nën sundimin osman 1354-1804 - Peter F. Sugar, Dituria, Tiranë 2007 • Brirët e dhisë - Artan Fuga, Ora Botime, Tiranë 2008 • Studime shqiptare - Johan Georg von Hahn, IDK botime, Tiranë • Kultura popullore në Evropë në fillimet e Kohës së Re - Peter Burke, Central Europe University Press, 1996 • Shteti mesjetar i Gjergj Kastriot Skënderbeut - Jahja Drançolli, Dukagjini, Pejë 2001 • Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit - Alija Izetbegović, Prishtinë 2002 • Skicë e mendimit politik shqiptar - Hysamedin Feraj, Logos-A, Shkup, 1999 • Origjinat e totalitarizmit - Hannah Arendt, Dija, Prishtinë, 2002 • Mesdheu - Fernand Braudel, IDK, Tiranë • Fundi i historisë dhe njeriu i fundit - Francis Fukuyama, Zenith, Prishtinë 2006 • Ku është gabuar - Bernard Lewis, SHLK, Tiranë 2004 • Lindja e Turqisë moderne - Bernard Lewis, SHLK, Tiranë 2004 • Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror - Samuel P. Huntington, Logos-A, Shkup 2004 • Culture and Imperialism - Edward W. Said, Chatto and Windus, London 1993 • Arratisje nga Lindja - Enis Sulstarova, Dudaj 2006 • Religjioni, konteksti shoqëror - Meredith B. McGuire, Logos A, 2007
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të dinë të operojnë në teori dhe në terren për të përforcuar lidhjen me të vërtetat e identiteteve;
2	Studentët do të dinë të ndërtojnë marrëdhënie sa më efektive komunikimi me komunitarët e lidhur pas identiteteve të caktuara.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	20	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			60
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			40
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	12	12
Gjysmë finale	1	16	16
Provimi final	1	18	18
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00